

URDHËR
Nr. 568, datë 9.10.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të kreut VII, të nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për procedurat e prokurimit publik në Ministrinë e Kulturës, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Entela Çipa.
 2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga data 9.10.2019 deri më 31.12.2019.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti